



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

MINISTRI

Nr. 6086/Prot.

Tiranë më 19/08/2015

URDHËR

Nr. 298, datë 19.08.2015

**PËR
CAKTIMIN E DATËS SË FILLIMIT TË VITIT AKADEMIK 2015-2016 NË
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 32 të ligjit nr.9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Viti akademik 2015-2016 në institucionet e arsimit të lartë, të fillojë në datën 12 Tetor 2015 dhe të përfundojë në datën 30 Shtator 2016.
2. Periudha 21 Dhjetor 2015 deri në 3 Janar 2015, të jetë periudhë pushimesh për studentët.
3. Institucionet publike të arsimit të lartë, në përfundim të regjistrimit të kandidatëve fitues, të dërgojnë në të gjitha ndërmarrjet "Trajtimi i Studentëve" sh.a., listën e studentëve të regjistruar, sipas programeve të studimit dhe fakulteteve përkatëse.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, Agjencia Kombëtare e Provimeve, ndërmarrjet "Trajtimi i Studentëve" sh.a dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

